

KULTURA 2023



Nr.20

kultura.gov.al

BULETINI MUJOR / GUSHT



SEZONI VEROR, AKTIVITETET KULTURORE MBUSHIN SHESHET E QYTETEVE

Koncerte, festivale, aktivitete mbi dhe Cirku Kombëtar mbledhën rreth vetes një trashëgiminë kulturore, artizanatin, librin, publik shumë të gjerë në qytetet bregdetare si por edhe teatër, shfaqje cirku e me kukulla mbushën sheshet e qyteteve tona turistike nga Veriu në Jug. Ministria e Kulturës dhe të gjitha institucionet e varësisë hartuan këtë vit një kalendar të pasur artistik, duke shtuar gjallërinë e qyteteve tona, të tejmbushur nga pushuesit shqiptarë e të huaj, që këtë vit zgjodhën Shqipërinë. Përgjatë muajit gusht Teatri Kombëtar i Operës, Baletit dhe Ansambli Popullor çoi te publiku koncerte në Durrës, Velipojë, Krujë e Shëngjin; Qendra Kombëtare e Librit dhe Leximit me Festivalin "Varg" udhëtoi drejt Pogradecit e Shkodrës; Qendra Kombëtare e Kulturës për Fëmijë

MINISTRIA E KULTURËS DHE TË GJITHA INSTITUCIONET E VARËSISË HARTUAN KËTË VIT NË KALENDAR TË PASUR ARTISTIK, DUKE SHTUAR GJALLËRINË E QYTETEVE TONA, TË TEJMBUSHUR NGA PUSHUESIT SHQIPTARË E TË HUAJ

me festivale muzikore apo dedikuar artizanatit, si ai i Porto Palermos, organizuar nga Olen Cesari, që mbledhi rreth vetes emra të njohur të muzikës shqiptare, për të vazhduar me festivalin "Nona" në Përmet, "Muza" në Durrës, "Diovani Lunxhiot" në Gjirokastrë etj.



RESTAUROHEN 7 MONUMENTE KULTURE NË QARKUN E VLORËS

Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore, Vlorë, përmbylli punimet për mirëmbajtjen, restaurimin dhe konsolidimin e monumenteve të kulturës. Falë punës së përditshme u janë kthyer vizitorëve dhe besimtarëve 7 monumente kulturore të kategorisë I, të cilat kishin problematika të ndryshme. Pas hartimit të projekteve nga ana e DRTK-së, Vlorë, dhe miratimit në Këshillin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore nisi puna për rehabilitimin e monumenteve: Banesa me dy peristile në Parkun Arkeologjik të Finiqit; kisha e "Shën Mërisë" në fshatin Melçan të bashkisë Finiq; "Puset e Vjetra" në fshatin Dhrovjan të bashkisë Finiq; Kisha e "Shën Mëhillit" në fshatin Kostar të bashkisë Finiq; Kisha e "Shën Janit" në bashkinë Delvinë; Muri rrethues i kishës së "Shën Mërisë Kamenor" në bashkinë Delvinë; Porta e kishës së "Shën Kollit" në fshatin Mesopotam.



FAMILJA E KRISTAQ DHAMOS I DHURON SHTETIT ARKIVIN PERSONAL TË KINEASTIT

Një pasuri e vyer iu shtua Arkivit Qendror Shtetëror të Filmit! Në përvjetorin e parë të vdekjes së kineastit të madh Kristaq Dhamo, një prej pionierëve të filmit shqiptar, familja i dhuroi Arkivit Qendror Shtetëror të Filmit një koleksion të pasur personal, që shërben jo vetëm për plotësimin e dosjes së kineastit, por edhe të historisë së kinematografisë shqiptare. Tashmë ky arkiv që mbart vlera të veçanta për familjen e kineastit, po kthehet në një pasuri publike. Bëhet fjalë për korrespondenca të kohës studentore me personalitete të artit të brezit të tij, shënime, komente, referate të mbajtura në simpoziume etj., që do t'u shërbejnë studiuesve dhe kritikëve. Kristaq Dhamo është një nga figurat më të shquara të kinematografisë shqiptare. Firmën e tij mban ndër të tjera edhe filmi i parë artistik me metrazh të gjatë, "Tana" (1958).

RESTAUROHET PIKTURA MURALE NË MUZEUN ETNOGRAFIK TË KRUJËS

Me mbështetjen e paçmuar të ekipit të konservimit nga Instituti i Konservimit në Universitetin e Arteve të Aplikuara në Vienë po dalin në dritë pikturat shumëngjyrëshe në mur dhe në dru në Muzeun Etnografik të Krujës. Së bashku me specialistët e angazhuar në procesin e restaurimit dhe rijetësimin të këtij monumenti, të përfshirë në Programin EU4Culture, ky ekip po kryen punimet më të imëta në një nga muzetë më të vizituar në Krujë. Gjatë muajit gusht ka vijuar puna për pastrimin përfundimtar, ruajtjen e objekteve dhe vendosjen e ekraneve. Shumë shpejt ky muze do t'i prezantohet publikut, tërësisht i rinovuar, me një koncept të ri dhe modern. Muzeu Etnografik i Krujës është një nga institucionet e përfshira në listën prioritare të ndërhyrjeve me mbështetjen financiare prej 40 milionë eurosh të Bashkimit Europian.



AZERBAJXHANI "RIKTHEN" JAVËT E KULTURAVE NDËRKOMBËTARE

Pas një shkëputjeje të shkurtër rikthehen Javët Kulturore Ndërkombëtare. Siparin e ngre kultura azerbajxhanase nga 31 gushti deri në 3 shtator. Një kalendar i pasur me ekspozita, koncerte dhe traditë kulinare. Dita e parë u hap me ekspozitën "Heydar Aliyev-100", në ambientet e Muzeut Historik Kombëtar, ku po ashtu u prezantua kulinaria e Azerbajxhanit, veçanërisht ëmbëlsirat tradicionale. Më pas festa u zhvendos në Sheshin "Skënderbej", ku në skenën e ngritur me këtë rast performoi Orkestra Shtetërore e Dhomës së Azerbajxhanit, "Gara Garayev". Koncerti u parapri me një interpretim të muzikantit Ibrahim Babayev, një ndër artistët më të njohur në Azerbajxhan, që ndërthur muzikën elektronike me atë tradicionale. Të pranishëm në koncert ishin ministrja e Kulturës Elva Margariti dhe zëvendësministri i Republikës së Azerbajxhanit, Jafarov Farid, ambasadori azerbajxhanas Anar Huseynov, përfaqësues të përfaqësive të tjera diplomatike në Tiranë dhe personalitete të artit.

DERI MË 3 SHTATOR DO TË SHPALOSET KULTURA AZERBAJXHANASE, ME NË KALENDAR TË PASUR ME EKSPOZITA, KONCERTE DHE TRADITË KULINARE. DITA E PARË U HAP ME EKSPOZITËN "HEYDAR ALIYEV-100"

"LOGU I BJESHKËVE", VAJZAT E MALËSISË PROMOJOJNË XHUBLETËN

Pranimi i xhubletës në listën e trashëgimisë kulturore botërore nën mbrojtjen e UNESCO-s është arsye dhe një përgjegjësi më shumë për ta ruajtur dijëbërjen dhe promovuar këtë veshje të rrallë të grave të Malësisë sonë. Jo vetëm si pjesë e traditës, por edhe për të festuar këtë pasuri të trashëgimisë sonë jomateriale, në bjeshkët e bukura të Kelmendit u zhvillua në datën 13 gusht 2023 aktiviteti tradicional "Logu i Bjeshkëve 2023". Një aktivitet i organizuar edhe me mbështetjen e Ministrisë së Kulturës, ku tinguj, valle, ngjyra, këngë dhe rituale stolisën me hijeshi e madhësi



ti skenën e amfiteatrit natyror në Qafë të Predelecit. Në paradë parakaluan vajzat e Bjeshkës, prej nga u zgjodhën edhe më të bukurat, si dhe një "koleksion" xhubletash të cilat ruhen me fanatizëm dhe trashëgohen brez pas brezi nga gratë e Malësisë.

KULTURA 2022



Nr.1
JANAR

kultura.gov.al



PËRFUNDON RESTAURIMI I KISHËS SË KEPIT TË RODONIT, U DËMTUA NGA TËRMETI



Përfundojnë punimet restauruese në Kishën e Shën Ndoit, në Kepin e Rodonit. Pas tërmetit të 26 nëntorit 2019, kisha e Shën Ndoit, një prej monumenteve të rralla të llojit të vet, rrethuar nga një peizazh mahnitës, ishte një nga objektet e dëmtuara nga lëkundjet sizmike, e cila u klasifikua si një nga monumentet e listës prioritare të programit prej 40 milionë

PALLATI I BRIGADAVE HAPET PËR PUBLIKUN

Ministria e Kulturës zhvilloi në ambientet e Pallatit Presidential (Pallati i Brigadave) konsultimin publik për hartimin e Planit të Menaxhimit të Integruar, të kësaj hapësire, shpallur "Ansambël Historik" dhe "Zonë e stimuluar"; me Vendim të Këshillit të Ministrave, në vitin 2004. Të pranishëm ishin specialistë të trashëgimisë kulturore, ministra, rektorë universitetesh, arkitektë etj. Në fjalën e saj, Ministria e Kulturës, Elva Margariti u shpreh se "Bashkë me Universitetin Politeknik të Tiranës, në kuadrin e "Paktit për Universitetin" kemi ndërmarrë hapin e hartimit të një Plani Menaxhimi të Integruar për Pallatin Presidential. Synimi ynë është që potenciali kulturor, turistik, ekonomik që ngërthen ky ansambël, njëkohësisht edhe "Zonë e stimuluar" të rrezatojë dhe të reflektohet në të gjithë zonën përreth, duke harmonizuar të gjitha investimet e qeverisë dhe të pushtetit lokal. Duke e kthyer këtë hapësirë në një pol të rëndësishëm zhvillimi

PREZANTOHET PLANI I MENAXHIMIT

pë zonën përreth". Më tej Ministria Margariti u shpreh: "Të konservosh dhe të rrijtësosh është një sfidë, por jam e bindur se do të gjejmë formulën e duhur që do të mundësojë shtimin e shërbimeve dhe funksioneve pa cenuar vlerat historike, arkitektonike të monumentit, dhe peizazhit rreth tij; të stimulojnë potencialin turistik që ka ky sit, por edhe ta kthejmë në një destinacion edukues për fëmijët, për të cilët do të ngrihen programe të dedikuara. Pallati Presidential nuk mund të jetë vetëm një muze i vetvetes, por nëpërmjet menaxhimit të qëndrueshëm, të mund të arrijë të gjenerojë të ardhura për të siguruar vazhdueshmërinë e ruajtjes, konservimit dhe restaurimit të tij.

40

MILIONË EURO
ËSHTË FONDI I PROGRAMIT
TË BASHKIMIT EUROPIAN,
EU4CULTURE.

eurosh të Bashkimit Europian, EU4Culture. Ndërhyrjet, të cilat u mundësuan prej një investimi prej rreth 90.000 eurosh, konsistojnë në ndërhyrje konsoliduese emergjente; restaurimin e dyshemesë; pastrimin e sistemit të kullimit dhe drenazhimit; realizimi i instalimeve elektrike të brendshme dhe të jashtme; sistemim të jashtëm etj. Ndërhyrjet më të fundit në këtë monument janë kryer në vitin 2000 me fonde të Republikës Federale të Gjermanisë. Më herët, në vitin 1978, me zbulimin e rrënojave, filloi menjëherë dokumentimi i tyre dhe disa konsolidime pjesore. Pas përfundimit të restaurimit të pikturave murale, kisha do të rinisë shërbesat e saj fetare, por edhe do të presë e përcjellë turistë.

U PËRURUA XHAMIA E ET'HEM BEUT, IU RIKTHYE BESIMTARËVE



Pas një pune trevjeçare u përrua në Tiranë Xhamia simbolike e Et'hem Beut, një investim i Agjencisë Turke për Bashkëpunim dhe Koordinim (TIKA). Ceremonia e përrimit të Xhamisë u zhvillua në datën 17 janar, me praninë e Presidentit të Republikës së Turqisë, Recep Tayyip Erdogan, kryeministrit shqiptar Edi Rama dhe personalitete të larta shtetërore të të dy vendeve. E ndërtuar mes viteve 1793-1823, Xhamia e Et'hem Beut është një objekt i rëndësishë së

NJË NGA NDËRHYRJET MË DELIKATE DHE TË VËSHITRA ISHTE PADYSHIM RESTAURIMI I PIKTURËS MURALE, E CILA ZË NJË HAPËSIRË PREJ 500 METRASH KATRORE.

veçantë, me vlera historike, arkitektonike e shpirtërore. Ndërrhyrjet e realizuara konsistonin në drenazhimin e themeleve në

gjithë perimetrin; përrforcimin e bazamentit të minares; hidroizolimim të themeleve; restaurimi total i minares dhe veshja me plumb e fundit të saj; veshja e kubesë me plumb; restaurimi i çatisë; i sistemit hidraulik dhe elektrik etj. Por një nga ndërhyrjet më delikate dhe të vështira ishte padyshim restaurimi i pikturës murale, e cila zë një hapësirë prej 500 metrash katrorë. Tashmë ajo ka dalë në dritë me gjithë madhështinë e saj dhe pret besimtarë e vizitorë.



BOTOHET DITARI I KARRIERËS SË AKTORES TINKA KURTI

U promovua në Tiranë libri "Tinka Kurti-Ditari i një bashkëshorti" i autores Anila Mema, mbështetur nga Ministria e Kulturës dhe Bashkia e Tiranës. Libri është dëshmia e një jete plot sakrificë e një prej përfaqësuesve kryesore të një plejade artistësh të jashtëzakonshëm, që themeluan artin skenik dhe atë kinematografik në Shqipëri. Është një copëz historie e kinematografisë shqiptare dhe një guidë për artistët e rinj. Në shenjë falenderimi për kontributin e saj të vyer shumëvjeçar, Ministria e Kulturës, Elva Margariti i dhuroi një simbol mirënjohjeje, një copëz shkëmb, ashtu si ajo ka përballuar jetën dhe karrierën.

RIJETËSOHET KULLA VENECIANE NË DURRËS, KTHEHET NË QENDËR INFORMIMI

Nisi puna për rijetësimin e Kullës Veneciane në Durrës. Restaurimi dhe rijetësimi i këtij monumenti do të mundësohet nëpërmjet programit EU4Culture, me një vlerë prej afro 690.000 eurosh. Hapi i parë i ndërhyrjeve është hidroizolimi i çatisë. Më tej, fasada e Kullës do t'i nënshtrohet pastrimit të kujdesshëm nga bimësia dhe papastërtitë. Në brendësi të Kullës do të realizohet nxjerrja në dritë e dyshemesë autentike prej guri, e cila do të konservohet dhe restaurohet. Objekti do të pajiset me sisteme të reja mekanike, elektrike dhe pajisje teknologjike.

690.000

EURO

DO TË KUSHTOJË
RIJETËSIMI I KULLËS
VENECIANE NË DURRËS

"ZGJOI", NJË FILM I MBËSHTETUR NGA QKK DHE MINISTRIA E KULTURËS DREJT ÇMIMIT OSCAR

Për herë të parë një film artistik me metrazh të gjatë, i financuar edhe nga Qendra Kombëtare Kinematografike e Shqipërisë dhe mbështetur nga Ministria shqiptare e Kulturës hyn në listën e shkurtër të kandidatëve për çmimin Oscar, në kategorinë e filmit të huaj. Bëhet fjalë për filmin artistik "Zgjoji" ("Hive") me regji të Blerta Bashollit, një bashkëprodhim mes Kosovës, Shqipërisë, Maqedonisë së Veriut dhe Zvicrës, i cili bën pjesë në listën e ngushtë të 15 prodhimeve ndërkombëtare për edicionin e 94-të të çmimit Oscar.